

**LIGJI Nr.04/L-177
PËR DËRGIMIN E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS JASHTË VENDIT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR DËRGIMIN E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS JASHTË VENDIT

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj rregullon procedurat e dërgimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (tutje FSK-së) jashtë vendit.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky ligj përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve në rastet e dërgimit të kontingjentit të FSK - së jashtë vendit si dhe procedurat për dërgim në operacione në mbështetje të paqes, operacione humanitare, trajnime dhe ushtrime jashtë vendit, mënyrën e tërheqjes dhe mënyrën e financimit.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorua në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Pjesëtarët e FSK-së** – konsiderohen pjesëtarët aktiv dhe pjesëtarët rezervë;

1.2. **Kontingjenti i FSK-së** – konsiderohet njësi i FSK-së i formuar dhe përgatitur për dërgim jashtë vendit i përbërë nga pjesëtarët aktiv, rezervë dhe pjesëtarët civil;

1.3. **Operacionet në mbështetje të paqes** – i referohet operacioneve dhe aktiviteteve që krijojnë kushte për paqe të qëndrueshme;

1.4. **Operacionet humanitare-** i referohet operacioneve për sigurimin e ndihmës në rast të katastrofave humanitare, teknike, teknologjike ose ekologjike të cilat mund të rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve, pasurisë, ambientit dhe për ofrimin e ndihmës në rast të shkatërrimeve nga lufta ose terrorizmi;

1.5. **Stërvitjet dhe Ushtrimet-** i referohet pjesëmarrjes në stërvitjet dhe ushtrimet individuale apo grupore të pjesëtareve të FSK-së jashtë vendit me qëllim të ngritjes së gatishmërisë operacionale.

Neni 4

Juridiksioni

Gjatë shërbimit jashtë kufijve territorial të Republikës së Kosovës, pjesëtarët e FSK-së u nënshtrohen ligjeve të Republikës së Kosovës dhe të vendit pritës, përveç nëse është vendosur ndryshe me Marrëveshjen e Statusit të Forcave.

Neni 5
Parapërgatitjet për dërgim jashtë vendit

1. Në operacionet jashtë vendit mund të dërgohen pjesëtarët e FSK-së, të cilët paraprakisht janë përgatitur, stërvitur dhe pajisur.
2. FSK i përcakton trajnimet dhe standardet që janë të nevojshme për përbushjen e misionit dhe sigurinë e pjesëtarë të FSK-së para dërgimit të tyre jashtë vendit. Ky trajnim mund të zhvillohet edhe jashtë Republikës së Kosovës në ndonjë vend partner apo organizatë ndërkombëtare.

Neni 6
Dërgimi i kontingjentit të FSK-së jashtë vendit

1. Me dispozitat e këtij ligji, dërgim jashtë vendit i FSK - së konsiderohet dërgimi i pjesëtarëve ose kontingjentit të FSK-së në:
 - 1.1. Operacionet në mbështetje të paqes;
 - 1.2. Operacionet humanitare;
 - 1.3. Stërvitje dhe ushtrime.

Neni 7
Operacionet në mbështetje të paqes

1. Dërgimi i kontingjentit të FSK - së në operacionet në mbështetje të paqes bëhet mbi bazën e marrëveshjeve me shtetin pranues, me ftesë të ndonjë organizate ndërkombëtare, apo me ftesë të ndonjërit nga shtetet anëtare të organizatave ndërkombëtare të sigurisë, si dhe me ndonjë Rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
2. Vendimin për dërgimin e kontingjentit të FSK - së jashtë vendit në operacionet në mbështetje të paqes e merr Kuvendi i Republikës së Kosovës, bazuar në propozimin e Qeverisë së Kosovës.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës autorizon dërgimin e kontingjentit të FSK-së në operacionet në mbështetje të paqes jashtë vendit pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
4. Në momentin e autorizimit nga Presidenti, Kryeministri në pajtim me autoritetin e Kuvendit, autorizon Ministrin e FSK-së për dërgimin e kontingjentit të FSK - së jashtë vendit.

Neni 8
Operacionet humanitare

1. Dërgimi i kontingjentit të FSK-së në operacionet humanitare bëhet mbi bazën e kërkesës për ndihmë nga shteti pranues, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, me ftesë të ndonjë organizate ndërkombëtare, apo me kërkesë të ndonjërit nga shtetet anëtare të organizatave ndërkombëtare të sigurisë si dhe me ndonjë Rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
2. Vendimin për dërgimin e kontingjentit të FSK - së jashtë vendit për operacionet humanitare e merr Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në propozimin e Ministrin të FSK-së apo cilido ministër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, varësisht se kujt i drejtohet kërkesa.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës pas marrjes së vendimit nga Qeveria, autorizon dërgimin e kontingjentit të FSK - së dhe njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës.
4. Në momentin e autorizimit nga Presidenti, Kryeministri autorizon Ministrin e FSK - së ta urdhërojë dërgimin e kontingjentit të FSK - së jashtë vendit.

Neni 9
Stërvitjet dhe ushtrimet

1. Dërgimi i kontingjentit të FSK-së në stërvitje dhe ushtrime jashtë vendit bëhet mbi bazën e ftesës nga shteti pritës të bazuar në marrëveshje bilaterale ose në kuadër të ftesës nga ndonjë organizatë ndërkombëtare.

2. Vendimin për dërgimin e kontingjentit të FSK - së në stërvitjet dhe ushtrimet jashtë vendit e merr Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Neni 10
Zëvendësimi i kontingjentit të FSK - së

Në rast të paraqitjes së kërkesës për vazhdimin e misionit të FSK-së jashtë vendit përtej kohëzgjatjes së paraparë me aktin e dërgimit, vendimi merret sipas procedurave të parapara për dërgimin në nenet 7, 8 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 11
Tërheqja e kontingjentit të FSK - së

1. Në rastet kur është e nevojshme që të mbrohen interesat e Republikës së Kosovës, me Vendim të Kuvendit përkatësisht të Qeverisë së Republikës së Kosovës në cilëndo kohë bëhet tërheqja e kontingjentit të FSK - së.

2. Bazuar në Vendimin e Kuvendit apo Qeverisë së Republikës së Kosovës, ashtu siç parashihet në paragrafin 1. të këtij neni, Presidenti i Republikës së Kosovës autorizon tërheqjen e kontingjentit të FSK – së.

Neni 12
Njoftimi

Nëse kërkohet, Presidenti i Republikës së Kosovës në kuadër të kompetencave që ka e njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me pjesëmarrjen e kontingjentit të FSK-së në operacione jashtë vendit.

Neni 13
Përgjegjësitë e ministrive dhe të institucioneve tjera shtetërore

Bazuar në kërkesën e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Vendimin e Qeverisë, ministrinë dhe institucionet tjera shtetërore janë të obliguara të ofrojnë ndihmë dhe shërbime nga veprimtaritë e tyre për dërgimin e kontingjentit të FSK -së jashtë vendit.

Neni 14
Përgjegjësitë e Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës

1. Ministri i FSK - së është përgjegjës:

1.1. t'i propozojë Qeverisë së Kosovës planin, dhe financimin e nevojshëm për aktivitetet e FSK-së në operacionet jashtë Kosovës;

1.2. të vendosë fillimin e procesit të planifikimit;

1.3. nëse kërkohet, të raportojë për procesin e dërgimit para Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Komandanti i FSK - së është përgjegjës për vlerësimin, organizimin, trajnimin dhe pajisjen e kontingjentit të FSK-së në mënyrë që të përmbushen kërkesat e dërgimit jashtë vendit.

3. Planifikimi, përgatitjet, stërvitja, zëvendësimin si dhe gatishmëria e kontingjentit të FSK - së për dërgim jashtë vendit, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Neni 15 Financimi

1. Mjetet e nevojshme për përgatitje, pajisje dhe dërgim të kontingjentit të FSK-së në operacione apo ushtrimet dhe stërvitjet jashtë vendit të parapara me nenin 6 të këtij ligji, përfshirë edhe të drejtat e parapara me paragrafin 2. të këtij neni, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Pjesëtarët e FSK - së do të kenë të siguar transportin, pajisjet e nevojshme për operacion dhe stërvitje, sigurimin shëndetësor, sigurimin jetësor, pagat, pagesat shtesë, si dhe ushqimin dhe akomodimin, si dhe kompensimin në rast të plagosjes apo vdekjes.

3. Zbatimi i paragrafit 1. dhe 2. i këtij neni do të rregullohet me akt të veçantë të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

4. Ministri i FSK - së ose Ministri i Punëve të Jashtme mund të negociojnë me organizatat ndërkombëtare dhe me vendet veç e veç për mbulimin e shpenzimeve për operacionet, trajnimet dhe ushtrimet jashtë vendit.

Neni 16 Aktet nënligjore

Të gjitha aktet nënligjore, të parapara me këtë ligj, përgatiten dhe miratohen nga institucionet përkatëse, në afat prej gjashtë (6) muajve, prej ditës kur ky ligj hyn në fuqi.

Neni 17 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet të gjitha dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Neni 18 Hyrja në fuqi

Ky ligj hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-177
02 maj 2013**

Shpallur me dekretin Nr.DL-023-2013, datë 20.05.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.